



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.17.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË PËR
FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Emine Fazliu, i cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni (udhëheqës i ekipit), Florë Berisha-Kutllovci dhe Agim Sogojeva (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	21
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/ 2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e ministrit në auditimin 2017

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Ne kemi analizuar veprimtarinë e MFSK-së, për të vlerësuar se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale, dhe për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes, deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MFSK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MFSK është e obliguar të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin e prokurimit;
- Raportet tremujore financiare; dhe
- Raportet operative (të performancës).

Në kontekst të PFV-ve nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Prandaj, deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Edhe për kërkesat tjera për raportim nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MFSK në përgjithësi ka vendosur kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit.

Aranzhimet e qeverisjes në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. MFSK ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në vazhdimësi ka kryer punë cilësore, përmes së cilës janë dhënë vlerësime lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	51,035,617	35,935,078	34,621,895	43,872,641	39,658,494
Granti i Qeverisë -Buxheti	51,035,617	35,934,864	34,621,681	43,862,855	39,658,494
Donacionet e brendshme	0	0	0	9,786	0
Donacionet e jashtme	0	214	214	0	0

Buxheti final në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 15,100,539€. Ky zvogëlim është si rrjedhojë e shkurtimeve buxhetore që janë bërë me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2017, Ministria kishte shpenzuar 96% të buxhetit final. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi një rënie për 3% të realizimit të buxhetit (99% - 2016).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	51,035,617	35,935,078	34,621,895	43,872,641	39,658,494
Pagat dhe Mëditjet	20,740,387	20,902,491	20,886,612	21,071,464	19,791,897
Mallrat dhe Shërbimet	10,765,230	9,992,410	8,941,674	8,190,467	8,333,078
Shërbimet komunale	950,000	950,000	814,849	802,211	812,100
Investimet Kapitale	18,580,000	4,090,177	3,978,760	13,808,498	10,721,419

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Tek kategoria e pagave dhe mëditje buxheti final ishte rritur për 162,104€. Nevoja për buxhet shtesë në kategorinë e pagave ka ardhur me rekrutimin e 63 ushtarëve nga radhët minoriteteve në vitin 2017, mbulimin e pagave për 14 kadetë të cilët kanë diplomuar në akademitë ushtarake dhe kanë dalë në gradën e parë të oficerit dhe për aktivizimin e Komponentit rezervë të FSK-së prej 367 pjesëtareve. Buxheti ishte realizuar pothuajse në tërësi;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është zvogëluar për 772,825€ si rezultat i kursimeve që janë bërë me vendime të Qeverisë;
- Buxheti final për shërbime komunale nuk kishte ndryshim të buxhetit nga ai fillestar, përderisa realizimi ishte 86%; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale buxheti final është zvogëluar për 14,489,823€ në raport me atë fillestar. Arsyet për reduktim janë të shumta (disa nga të cilat jashtë ndikimit të MFSK-së), dhe përfshijnë mos realizimin e shumë projekteve, si pasojë e mos-aprovimit nga ana e Qeverisë për përjashtimin e prokurimeve të veçanta, pastaj dërgimi i disa projekteve në Agjencinë për Prokurim Publik (AQP) për realizimin e prokurimeve të centralizuara, reduktimit të alokimeve nga Qeveria etj. Kjo ka ndikuar që shuma të konsiderueshme të deklarohen si kursime buxhetore. Rrjedhimisht me rishikim të buxhetit janë deklaruar si kursime buxhetore vlera prej 5,508,645€, një pjesë e buxhetit nga këto projekte ishte reduktuar nga alokimi me vendimin e Qeverisë nr.08/151 të datës 02.08.2017. Poashtu me rishikim të buxhetit dhe me vendimin e njëjtë të Qeverisë, është marrë nga alokimet në projekte kapitale shuma prej 7,302,415€. Me vendimin e Qeverisë nr.10/19 të datës 15.12.2017 është marrë buxheti prej 48,602€, dhe me vendimin e Qeverisë nr. 02/22 të datës 27.12.2017 është marrë buxheti i pa shpenzuar në vlerë prej 1,630,161€, (nga kjo pjesë, mjete të zotuar ishin 262,425€ dhe urdhër blerje të lëshuara në vlerë prej 1,367,736€).

Çështja 1 – Realizimi i buxhetit

E gjetura Realizimi i buxhetit për investime kapitale ishte sfidë me të cilën është përballuar MFSK gjatë vitit 2017. Buxheti final për investime kapitale është realizuar rreth 97%. Megjithatë nëse i shohim lëvizjet e buxhetit në këtë kategori në mes të buxhetit fillestar dhe atij final, shohim se kjo kategori ishte reduktuar për 14,489,823€. Pavarësisht se disa nga faktorët që kanë ndikuar në këtë ishin jashtë menaxhimit nga MFSK, kjo çështje lë hapësirë për përmirësim të mëtejshëm.

Për me tepër, dinamika e shpenzimit të buxhetit nuk ishte në harmoni të plotë me planin e rrjedhës së parasë, pasi që rreth 50% e buxhetit për investime kapitale ishte shpenzuar në tremujorin e fundit.

Rreziku Reduktimi i dukshëm i fondeve, dhe mos realizimi i projekteve kapitale e dobësojnë performancën e përgjithshme financiare të Ministrisë. Më tutje, shpenzimi i buxhetit në fund të vitit ndikon në rritjen e vëllimit të punës dhe rrjedhimisht rrit mundësinë që pagesa të caktuara tu ikin kontrolleve adekuate dhe mund të pasojnë me lëshime apo gabime.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar për projektet kapitale.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe nga MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MFSK-së, e të cilat ndërlidhen me rekrutimet, përcaktimin e gradave të pagave, avancimin dhe aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme. Në këtë kategori të shpenzimeve gjatë vitit 2017 ishin shpenzuar 20,886,612€ apo 99% e buxhetit final. Testimet tona nuk kanë identifikuar ndonjë çështje për tu ngritur në raport.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra ka rezultuar çështja në vijim:

Çështja 2 - Plotësimi i pozitave me ushtrues të detyrës më gjatë se tre muaj

- E gjetura** Sipas Ligjit të Shërbimit Civil nr.03-L-149, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Ne kemi identifikuar dy raste ku drejtorët e departamenteve ishin caktuar ushtrues detyre që nga viti 2014.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave kyçe me UD në periudha të gjata kohore rrit rrezikun që performanca e zyrtarëve në ato pozita të mos jetë e mirë. Rrjedhimisht kjo mund të ndikojë në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të inicohen procedurat për rekrutim për plotësimin e këtyre pozitave me stafit të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 10,942,410€. Prej tyre ishin shpenzuar 9,756,523€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me furnizim me pjesë rezervë për automjetet e FSK-së, furnizim me ushqim, furnizim me veshje sportive për nevojat e FSK-së, furnizim me pajise të shërbimit policor për policinë e FSK-së, furnizime me material për zyre, shpenzime komunale etj. Testimet tona bërë kësaj fushe nuk kanë evidentuar ndonjë çështje për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,090,177€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,978,560€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me Ndërtimin dhe rregullimin e objekteve për FSK-në, Rekonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në kazermën e FSK-së në Prishtinë, Ndërtimi i depove për logjistikë në kazermën e FSK-së në Prishtinë e tjera. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë çështje materiale, me përjashtim të disa mangësive procedurale të cilat janë paraqitur më poshtë.

Çështja 3 – Vonesa në vlerësimin e ofertave

E gjetura Sipas nenit 35 të Udhëzuesi Operativ për prokurimin publik - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve përcakton që vlerësimi i tenderëve duhet të kryhet nga Autoriteti Kontraktues (AK) brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Megjithatë ne kemi gjetur se në katër² raste procesi i vlerësimit kishte pasur vonesa në krahasim me 30 ditëshin e potencuar më lartë (vonesat ishin 19-26 ditë).

Arsyet e vonesave të tilla sipas departamentit të prokurimit janë: mungesa e stafit në zyrën e prokurimit dhe zbatimi për herë të parë i platformës elektronike të prokurimit, me ç'rast disa herë ka ndodhur që nuk ka funksionuar apo ka pas vështirësi në shkarkimin/ngarkimin e dokumenteve.

Rreziku Vonesat në zhvillimin e procedurave të vlerësimit, përveç se janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjithashtu e rrisin rrezikun që projektet kapitale të ketë vonesa në realizim. Kjo mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës shtim të kontrolleve dhe të fokusit në këtë pjesë të procesit të prokurimit, në mënyrë që të përmushen kërkesat e rregullave të prokurimit dhe për të evituar vonesat eventuale në realizimin e projekteve të caktuara.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (me vlera mbi 1,000€) e paraqitur në PFV ishte 145,785,598€, vlera e pasurive jo kapitale (me vlera nën 1000€) ishte 1,531,792€, ndërsa vlera e stokeve e shpalosur në PFV ishte 2,156,371€. Në bazë të planit të auditimit ne kemi ekzaminuar mostra në këtë kategori, ku janë aplikuar teste substanciale dhe të pajtueshmërisë. Gjithashtu kemi kryer ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë çështje për raportim.

² 'Kontrata Renovimi i objektit të policisë së Forcës në Kazermën e FSK - së Prishtinë, në vlerë prej 126,940€', 'Ndërtimi i objektit të rojës në kazermat e FSK-së në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, projekt dy vjeçar i cili është i ndarë në dy faza 2017 dhe 2018), në vlerë prej 468,683€', 'Ndërtimi i poligonit të reagimit të udhëheqësve në kazermën e FSK-së në Ferizaj, në vlerë prej 126,244€', dhe 'Furnizim me pjesë rezervë për automjete për nevojat e FSK-së me vlerë 261,884€'.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Obligimet e papaguara

MFSK, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF-të për vitin 2017 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore. Vlera e obligimeve ishte 196,066€, dhe se këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Në raport me vitin 2016, MFSK ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguara, duke reduktuar dukshëm obligimet në fund të vitit (obligimet e papaguara në fund të vitit 2016 ishin 462,578€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2016 kishte rezultuar me katër rekomandime. MFSK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime ishin zbatuar, një ishte në proces të zbatimit dhe një rekomandim nuk ishte adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur dy rekomandime të cilat janë zbatuar gjatë vitit 2017. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak

E gjetura	Edhe përkundër përpjekjeve të menaxhmentit për zbatimin e rekomandimeve, MFSK ende nuk kishte arritë ti adresoj të gjitha rekomandimet e AP-së nga viti i kaluar. Sfidë mbetet adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me ushtruesit e detyrës dhe vonesat në vlerësimin e tenderëve.
Rreziku	Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuarra, dhe si rezultat në vazhdimësi kemi përsëritjen e mangësive të njëjta.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të inicoj një vlerësim të progresit rreth realizimit të planit të veprimit, për të identifikuar barrierat që po pengojnë zbatimin e rekomandimeve dhe të përcaktojë masat e nevojshme për tejkalimin e këtyre barrierave.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e Zyrtarit Kryesor Administrativ me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi që kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve nga ekipi ynë i auditimit lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MFSK në vazhdimësi ka treguar gatishmëri në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara. Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah se MFSK ka vendosur kontrolle adekuate në aktivitetet operative dhe financiare.

Gjithashtu, MFSK ka përgatit planin vjetor të organizatës në përputhje me atë strategjik dhe planin për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të arritjes së objektivave. Për më tutje, MFSK ka përgatitur edhe regjistrin e rreziqeve dhe planin për menaxhimin e tyre.

Duhet të theksojmë që Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi ka treguar një cilësi të lartë të punës përmes së cilës ka dhënë vlerësime të qëndrueshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti i MFSK-së për përmirësimin e fushave me mangësi.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtar - drejtori i NjAB-së dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Ministrisë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv.

NjAB, në planin vjetor për vitin 2017, kishte planifikuar tetë auditime të rregullta. Plani vjetor ishte bërë në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe prioriteteve. Ky plan ishte realizuar plotësisht, derisa auditimet kanë mbuluar fushat me rrezik të lartë dhe të mesëm.

Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

Po ashtu NjAB kishte raportuar në baza tremujore, dhe kishte dorëzuar raportin vjetor në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, ku kishte prezantuar punën dhe aktivitetet e kryera gjatë vitit 2017.

Komiteti i Auditimit (KA), kishte mbajtur katër takime ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NJAB-së. Në këto takime komiteti ka rekomanduar që ministri të nxjerr vendim me anë të të cilit caktohen afatet për secilën fazë të implementimit të rekomandimeve.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Ato përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti i MFSK-së ka dizajnuar sisteme të mira të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Ne kemi marrë siguri nga funksionimi i kontrolleve të brendshme dhe jemi mbështetë në funksionimin e tyre.

Procesi i raportimit të brendshëm në MFSK funksionon sipas zinxhirit llogaridhënës dhe atij komandues të parashikuar me ligjin dhe strukturën organizative të MFSK-së dhe FSK-së. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj. Temat dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë kërkesat për vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

MFSK ka plotësuar kërkesat e MFK-së duke e hartuar matricën e rreziqeve të mundshme, ku janë përfshirë identifikimi, vlerësimi, trajtimi i rreziqeve si dhe analizimi dhe raportimi përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve. Janë përcaktuar edhe llojet, gjasat e ndodhjes së rreziqeve, veprimet që do të ndërmerren nga departamentet përkatëse dhe afatet brenda të cilave do të bëhet monitorimi tyre.

Çështja 5 - Monitorimi i rreziqeve

- E gjetura** Sipas kërkesave të MFK-së, regjistri i rrezikut duhet të ketë datë dhe të rishikohet rregullisht (rekomandohen rishikime tremujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprimet ashtu siç është planifikuar dhe nëse është bërë ndonjë ndryshim në vlerësimet e rrezikut. Regjistri i rishikuar i rrezikut, duhet të nxirret pas secilit rishikim dhe të azhurnohet sipas nevojës, MFSK kishte bërë monitorimin vjetor të listës me rreziqe, mirëpo jo në baza tremujore siç kërkohet me procedurat e MFK-së.
- Rreziku** Mungesa e monitorimit /rishikimit të vazhdueshëm të rreziqeve nga ana e menaxhmentit, rrit rrezikun që objektivat e organizatës nuk do arrihen plotësisht. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj që lista e rreziqeve, po monitorohet në vazhdimësi, në baza tremujore, për të reduktuar ndikimin në nivele të pranueshme, si dhe të merren veprimet e duhura, në rastet kur janë të nevojshme, për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Për rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		Edhe pse menaxhmentit kishte bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve ende nuk kishte arritë që ti adresoj në nivelin e kënaqësëm, mbetet sfidë adresimi i plotë i rekomandimeve të dhëna.	
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha dosjet e personelit janë të plotësuara në përputhje me legjislacionin dhe azhurnohen me qëllim të përforcimit të kontrolleve të brendshme. Me tutje të sigurojë përshtetshmëri të qartë të detyrave dhe përgjegjësi për të gjithë punonjësit e organizatës me qëllim të ngritjes së performancës së tyre dhe organizatës në përgjithësi.	Është zbatuar.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të përmirësoj nivelin e kontrolleve në mënyrë që vlerësimi dhe realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.			Nuk është zbatuar

3.1.3 Investimet kapitale	Ministri duhet të shtojë masat e kontrollit mbi njësitë e planifikimit, që gjatë hartimit të buxhetit për projekte kapitale të bëhet një llogaritje e arsyeshme dhe reale si dhe analizë më detaje e çmimeve të tregut. Bazuar në këtë planifikimi mund të jetë më i përafërt me realizimin e kontratave. Me tutje në rastet e tejkalimeve prej 25% të kërkohet aprovimi nga Kuvendi.	Është zbatuar		
---------------------------	---	---------------	--	--

Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANUAR/DOBEZIMAR: DATE/ACCEPTED/ISSUED:		24. 05. 2018	
Kësia Org. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranice No. Pages
03	400	757	1



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Niveli Org. Org. Unit		Niveli Org. Org. Unit	
217		1438	
N. Klasifik. Class. Code		N. Klasifik. Class. Code	
1		24.05.2018	
Prishtinë / Pr			

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës-Ministarsvo za Kosovske Bezbednoste
Snage-Ministry for the Kosova Security Force

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Rustem Berisha

Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës,

Data: 23. Maj. 2018, Prishtinë